



# BULETINI

korrik, gusht, shtator 2010

Numr 7/2010

## Përmbajtja

- Seminar E Drejta e BE së IGJK & TWINNING
- Programi Fillestar për Arsimim Ligjor
- Programi i Trajnimit për Avancim Moduli – Ndërtimi i Shkathësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit
- Tryezë Diskutimesh: Marrëveshja për pranimin e fajësisë
- Trajnimet praktike të kandidatëve të gjeneratës së dytë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor
- Ceremonia për fillimin e trajnimeve të gjeneratës së tretë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë
- Tryezë e Diskutimeve: Civile Masat Mbrojtëse dhe Ndikimi i tyre në Parandalimin e Dhunës në Familje
- Tryezë e Diskutimeve: Penale Rehabilitimi Ligjor dhe Rehabilitimi Gjyqësor
- Tryezë Pune (Regjionale) Ligji Penal për të Mitur i Kosovës Regjioni: Prishtinë IGJK- UNICEF
- Tryezë e Diskutimeve: Penale Krimi i Organizuar
- Trajnim për Trajnues: Zhvillimi i Shkathësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit
- Seminar Roli i Zyrës së Prokurorit Disiplinor
- Trajnim - Penale E Drejta e BE-së IGJK& TWINNING

**ZHVILLIM  
PROFISIONAL  
GJYQËSOR**

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr.  
"Muharem Fejza" pa.nr.  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069  
+381 (0) 38 512 081 +381 (0) 38  
512 095 www.kjjudicial.org in-

## Seminar E Drejta e BE-së IGJK & TWINNING



Nga 5 deri 9 korrik 2010, IGJK në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit i cili mbështetë reformimin e sistemit të arsimit ligjor në Kosovë, mbajti një trajnim pesë ditor nga e Drejta e BE-së me temën e lartpërmendur. Në këtë trajnim u trajtuan çështjet lidhur me:

- Të Drejtën Evropiane-Historia e saj,
- Struktura organizative e Bashkimit Evropian,
- Lidhja në mes të Drejtës Evropiane dhe Konventës Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut,
- Burimet e së Drejtës Evropiane,
- Epërsia e së Drejtës Evropiane mbi të Drejtën Kombëtare, si dhe
- Liritë fundamentale në të Drejtën Kombëtare.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan shumë shembuj nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë si dhe u bë analizimi i këtyre rasteve nga pjesëmarrësit. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të cilët punojnë në lëmin penale dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Programi Fillestar për Arsimim Ligjor

Gjatë muajit korrik si pjesë e Programin Fillestar për Arsimim Ligjor është organizuar Provimi Përgatitor për gjeneratën e tretë të kandidatëve të PFAL. Provimi Përgatitor është mbajtur me datë 3 korrik (pjesa me shkrim), ndërsa pas vlerësimit të provimit nga ana e komisionit dhe verifikimit të rezultateve, me 17 korrik është mbajtur provimi me gojë. Nga ky provim kanë dal 31 kandidatë të cilët do të ndjekin trajnimet në PFAL duke filluar nga shtatori. Kandidatët e gjeneratës së dytë i janë nënshtruar provimit përfundimtarë të fazës së dytë të PFAL. Me qëllim të përgatitjes për fazën e tretë të trajnimeve

të PFAL për kandidatët e gjeneratës së dytë si dhe përgatitjet për fillimin e fazës së parë të trajnimeve për gjeneratën e tretë janë mbajtur disa takime si ai me; Koordinatorët e Mentorëve, me trajnuesit e fazës së parë të PFAL, takimi me Mentorët, takimi me kandidatët e PFAL II si dhe takimi me kandidatët e PFAL III. Në muajin korrik ka filluar faza e tretë e trajnimeve për gjeneratën e dytë gjatë së cilës periudhë kandidatët kanë qenë të angazhuar në përgatitjen e revistës shkencore "Justicia".

## Programi i Trajnimit për Avancim Moduli Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit

Në kuadër të Programit për Avancim, më 28, 29 dhe 30 korrik 2010, Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-ve, OPDAT, dhe Institutin Kombëtar të Avokimit gjatë Gjykimit (NITA) nga SHBA-të, ka realizuar një sesion trajnimi treditör me temën e lartpërmendur. Temat të cilat u trajtuan në këtë sesion kryesisht kishin të bënin me teknikat e marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, të tërthortë, vënien në dyshim dhe rimarrjen në pyetje të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, si dhe teknikat e paraqitjes së fjalës hyrëse dhe argumentimit përfundimtar, si nga ana e prokurorit ashtu edhe nga ana e avokatit mbrojtës.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes punës në grupe të demonstrojnë shkathtësitë e tyre të përfaqësimit gjatë gjykimit, duke punuar rreth një rasti praktik dhe duke përdorur teknikat e prezantuara nga trajnuesit vendor të trajnuar enkas për këtë trajnim.

Vlen të përmendet se prezantimet e trajnuesve dhe puna e pjesëmarrësve është incizuar, ndërsa pjesëmarrësit iu kanë nënshtruar sugjerimeve dhe udhëzimeve për të në mënyrë që të jenë më mirë të përgatitur për kryerjen e funksioneve të tyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, nga Gjykatat e Qarkut, si dhe prokurorë nga Prokuroritë e Qarkut.

### Tryezë Diskutimesh Tema : Marrëveshja për pranimin e fajësisë

Më 24, 25 dhe 26 gusht 2010, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës - Zyra Tejoqeanike për Zhvillim, Ndihmë dhe Trajnim Prokurorial( OPDAT) ka realizuar tre sesione trajnuese me temë **Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë**.

Objektivë kryesore e këtyre sesioneve ishte analizimi i problemeve rreth zbatimit praktik të dispozitave ligjore në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe ngritja e nivelit të zbatimit më me sukses të këtij instituti të ri juridik në praktikën gjyqësore të Kosovës.

Në cilësi të trajnuesit ishin ekspert me përvojë disa vjeçare nga SHBA-të, ndërsa pjesëmarrës të trajnimit ishin prokurorë, avokat dhe gjyqtarë nganga të gjitha regionet e Kosovës.



### Trajnimet praktike të kandidatëve të gjeneratës së dytë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor

Fillimi i muajit gusht ka shënuar edhe fillimin e trajnimeve praktike të kandidatëve të gjeneratës së dytë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor, të cilët tashmë ishin vendosur në gjykata dhe prokurori varësisht nga profili i tyre.

Gjatë kësaj kohe kandidatët nën mbikëqyrjen e Mentorëve të caktuar nga IGJK-ja, në bashkëpunim me KGJK-në, kanë përcjellë punën praktike të gjykatave dhe prokurorive si dhe janë angazhuar në realizimin e

programit praktik të përcaktuar për këtë fazë. Kandidatët janë vizituar nga zyrtarë të lartë të IGJK-së për të parë sistemin e tyre, kushtet në të cilat janë duke punuar, nevojat për mbështetje, koordinimin me Mentor, mundësitë e realizimit të programit trajnues si dhe mundësitë e mbështetjes nga IGJK-ja.

Në këtë drejtim me qëllim të ofrimit të kushteve sa më të mira për punë, IGJK-ja ka dërguar kompjuter në disa gjykata dhe prokurori të cilat nuk kanë pasur pajisje të mjaftueshme

## Ceremonia për fillimin e trajnimeve të gjeneratës së tretë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë



Më 1 shtator 2010, është organizuar ceremonia për fillimin e trajnimeve të gjeneratës së tretë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët do të ndjekin trajnimet për një periudhë 15 mujore. Në këtë ceremoni ka marrë pjesë Presidenti i Republikës z. Fatmir Sejdiu si dhe personalitete të shumta vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues

të institucioneve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe mekanizma tjerë që mbështesin këtë sektor siç janë:

Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Kryeprokurori i Shtetit, Ministria e Drejtësisë, përfaqësues të EULEX-it, të Komisionit Evropian, USAID-it, UNDP-së, OSBE-së si shumë miq, bashkëpunëtor dhe donator tjerë të IGJK-së. Më 3 shtator ka filluar trajnimi i PFAL dhe ka vazhduar sipas planit dhe kalendarit të parashikuar trajnimet e muajit shtator.

Ndërsa lidhur me mbarëvajtjen e trajnimeve në fazën e tretë të gjeneratës së dytë me datë 10 shtator është mbajtur takimi në mes Koordinatorëve të Mentorëve dhe kandidatëve të PFAL.

Qëllim i këtij takimi ishte prezantimi i kandidatëve për punën e tyre të realizuar në këtë fazë si dhe sfidat profesionale me të cilat po ballafaqohen gjatë punës praktike.

IGJK-ja dhe Koordinatorët e Mentorëve i inkurajuan ata që të vazhdojnë angazhimin maksimal në trajnimet praktike, pasi që kjo është faza e fundit ku ata do të kenë mundësi të përfitojnë profesionalisht nga mentorët para se ata vet të fillojnë ushtrimin e funksionit të gjyqtarit apo prokurorit.

## Tryezë e Diskutimeve: Civile Masat Mbrojtëse dhe Ndikimi i tyre në Parandalimin e Dhunës në Familje

Instituti Gjyqësor i Kosovës më 03 shtator 2010 ka organizuar tryezën e diskutimeve në lëmin civil me temë: **“Masat mbrojtëse dhe ndikimi i tyre në parandalimin e dhunës në familje”**.

Vlera e kësaj tryeze për gjyqtarë ishte se mundësoi ofrimin e njohurive më të avancuara lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (03/L-182), shpjegimin e masave mbrojtëse dhe ndikimin e tyre në parandalimin e dhunës në familje, dallimet në mes masave mbrojtëse dhe atyre urgjente si dhe dallimet në vendimet gjyqësore dhe arsyetimi i pamjaftueshëm i tyre.

Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarë, prokurorë, avokatë, zyrtarë të SHPK, dhe përfaqësues të qendrave për punë sociale të gjitha regjioneve të Kosovës.





## Tryezë e Diskutimeve: Penale Rehabilitimi Ligjor dhe Rehabilitimi Gjyqësor

IGJK më 07 shtator 2010 ka realizuar tryezën e diskutimeve me temën e lartpërmendur. Gjatë kësaj tryeze janë diskutuar çështjet rreth kushteve për rehabilitim ligjor dhe rehabilitim gjyqësor duke përfshirë procedurat që duhet të zbatohen për të zbatuar në jetë cilindo qoftë nga rehabilitimet e përmendura.

Me këtë rast u theksua i çështjeve problematike nga këndvështrimi praktikë i zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë këtë sferë.

Në veçanti u theksua mos ekzistimi i një baze të të dhënave, ku do të evidentoheshin personat ndaj të cilëve është bërë rehabilitimi për faktin se rehabilitimi i cilit do lloj qoftë ka ndikim pozitiv në risocializimin dhe ri integrimin e personave të dënuar si dhe rikthimin e prestigjit dhe adaptimin e tyre në jetën qytetare.

Pjesëmarrës të kësaj tryeze ishin gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorë profesional nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Tryezë Pune (Regjionale) Ligji Penal për të Mitur i Kosovës Regjioni: Prishtinë IGJK- UNICEF



Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me UNICEF-in, më **16 shtator 2010** ka realizuar një tryezë pune me temë **Kodi i Drejtësisë për të Mitur**. Në kuadër të kësaj tryeze është diskutuar rreth plotësimeve dhe ndryshimeve të Ligjit Penal për të Mitur të Kosovës i cili tashmë është shndërruar në Kod, pengesat e ndryshme të paraqitura në punën praktike të gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve sprovues, organit të kujdestarisë dhe pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Trajnimitin e karakterizonte fryma konstruktive për gjetjen e rrugëve më të lehta që dispozitat e reja të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë unike dhe të drejtë. Pjesëmarrës në trajnim ishin gjyqtarë, avokat, polic, zyrtarë nga shërbimi sprovues, qendra për punë sociale dhe një zyrtar ligjor nga EULEX.

## Tryezë e Diskutimeve: Penale Krimi i Organizuar

Më 16 shtator 2010, IGJK ka realizuar tryezën e diskutimeve lidhur me **Krimin e Organizuar**. Gjatë kësaj tryeze janë diskutuar shumë çështje rreth luftimit të krimit të organizuar, kualifikimit të drejtë të veprave penale të cilat hyjnë në domenin e krimit të organizuar si dhe vlerat e rrezikuara me këto vepra të rrezikshme për shoqërinë. Ndërsa në veçanti është diskutuar lidhur me krimin financiar si dhe trafikimin me njerëz dhe me drogë. Me këtë rast u theksua se luftimi i këtyre dukurive me element kriminal mbetet rruga e vetme për të ecur përpara, ndërsa Institucionet e autorizuara për luftimin e krimit financiar në Republikën e Kosovës janë: Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit të Kosovës, Gjykatat e Republikës së Kosovës, Doganat



Administrata Tatimore, Banka Qendrore e Kosovës, Qendra e Informimit Financiar, etj. Pjesëmarrës të këtij trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Trajnim për Trajnues: Zhvillimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit

Më 02, 13, 20 dhe 27 shtator 2010, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-ve, OPDAT, dhe Institutin Kombëtar të Avokimit gjatë Gjykimit (NITA) nga SHBA-të, ka realizuar disa sesione trajnimi për trajnues.

Gjatë këtyre sesioneve trajnuese, nga ana e trajnuesve vendor dhe ndërkombëtarë u demonstruan forma të ndryshme të metodologjive moderne të cilat duhet t'i përdorin trajnuesit me rastin e prezantimeve të tyre lidhur me teknikat e

marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, ë drejtpërdrejtë, të tërthortë, vënien në dyshim dhe rimarrjen në pyetje të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, si dhe teknikat e paraqitjes së fjalës hyrëse dhe argumentimit përfundimtar, si nga ana e prokurorit ashtu edhe nga ana e avokatit mbrojtës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarkut, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, Gjykata Komunale si dhe prokurorë nga Prokuroria Speciale e Kosovës.

## Seminar Roli i Zyrës së Prokurorit Disiplinor

Më 23 shtator 2010 IGJK ka realizuar seminarin me temë **Roli i Zyrës së Prokurorit Disiplinor** në kuadër të të cilit janë diskutuar roli dhe kompetencat e zyrës së prokurorit disiplinor.

Temat të cilat u analizuan gjatë këtij sesioni trajnues kryesisht janë përqendruar në përgjegjësitë dhe obligimet e Zyrës së Prokurorit Disiplinor si dhe çështjet që i përkasin zhvillimit të procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve,

gjyqtarëve porotë dhe prokurorëve.

“Me këtë rast u konkludua se Zyra e Prokurorit Disiplinor nuk është themeluar që të ndikoj në pavarësinë e gjyqtarit apo prokurorit, por që ta forcoj atë dhe të rrit besimin qytetarëve për sistemin gjyqësor dhe prokurorial si dhe ta forcoj sundimin e ligjit.

Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Trajnim - Penale E Drejta e BE-së IGJK& TWINNING



Më datën 27, 28, 29, 30 shtator dhe 1 tetor 2010, IGJK në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit i cili mbështet reformimin e sistemit të arsimimit ligjor në Kosovës, mbajti një trajnim pesë ditor nga e Drejta e BE-së me temën E Drejta Evropiane në praktikë: hyrje dhe përqendrimi në të Drejtën Penale.

Në këtë Trajnim u diskutuan çështjet lidhur me:

- Të drejtën Evropiane - Historia e saj,
- Lidhja në mes të Drejtës Evropiane dhe Konventës Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut,
- Trafikimi me qenie njerëzore, me armë dhe substanca narkotike,
- Njohja reciproke në të Drejtën Penale: legjislacioni dhe instrumentet,
- Epërsia e zbatimit të të Drejtës Evropiane; legjislacioni në Evropë,
- Gjykata e Bashkimit Evropian: përbërja e saj, detyrat dhe kompetencat,
- Fushat e specializuara të Drejtës Evropiane në fushën e të Drejtës Penale.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan shumë shembuj nga praktika gjyqësore e Gjykatës së BE-së dhe u bë analizimi i këtyre rasteve nga ana e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të cilët punojnë në lëmin penale dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.